



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "One-Grup" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Intervenime Emergjente", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2633-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-034-221, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "One-Grup" sh.p.k., e dt.25.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Intervenime Emergjente", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2633-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-034-221, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 10.04.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 10.04.2025;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.



Arsyetim

Operatori ekonomik "One-Grup" sh.p.k. me dt.25.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Intervenime Emergjente", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-2633-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-034-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 28.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur nuk qëndron, sepse , nuk është bërë asnjë shkelje e natyrës së diskriminimit për arsye se ne rastet emergjente kompania e cila do ta fiton tenderin duhet të ketë makineri në numër si dhe vozitësit në numër. Rastet emergjente janë ta paparashikueshëm dhe nuk dihet se kur ndodhin dhe intervenimet duhet te jene të menjëhershme.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

